



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

Kodi: 037

KEC

MËSIMI PROBLEMOR

Objektivat e programit:

Me përvetësimin e këtij programi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- të demonstrojnë aftësi për organizimin e mësimit problemor,
- të jenë në gjendje të bëjnë integrimin e lëmive kurrikulare në projekte origjinale, pavarësisht ose në bashkëpunim me kolegët,
- të menaxhojnë procesin e zbatimit të një projekti mësues, duke aplikuar metoda të përshtatshme të monitorimit dhe këshillimit të nxënësve/studentëve,
- të jenë në gjendje të vlerësojnë përmbajtjen e projekteve mësimore dhe shkathtësitë e nxënësve/studentëve në bazë të kriterëve që aplikohen në praktikën profesionale.

Përmbajtja

Shkathtësistë e shekullit XXI: përgjegjësia personale dhe shoqërore; planifikimi, të menduarit kritik, rezonimi dhe kreativiteti; shkathtësitë për komunikim me të tjerët; të kuptuarit e kulturave të tjera; vizuelizimi dhe vendimmarrja; njohuri për përdorimin e teknologjisë. Çka është mësimi problemor? Përfitimi nga mësimi i bazuar në projekte. Elemente të mësimit të bazuar në projekte: pyetja, plani, orari i aktiviteteve, monitorimi, vlerësimi dhe reflektimi. Përgatitja e formularëve për formulimin, menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e projektit. Përvojat e ndryshme të zbatimit të mësimit problemor në arsim.

Grupi i synuar

Ky program i dedikohet mësuesve, si dhe të gjithë atyre që tregojnë interesim për të zotëruar teknikat e mësimit problemor dhe të mësimit të bazuar në projekte.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja

Programi organizohet në formë të një seminari 1-ditor dhe ka gjithsej **8 orë**.

Certifikimi

Kusht për certifikim është pjesëmarrja e plotë në seminar.